

Miratohet krijimi i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Këshilli i Ministrave miratoi propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për krijimin e "Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët". Kjo qendër do të ketë si qëllim studimin e specializuar të historisë, letërsisë dhe kulturës së komunitetit arbëresh. Pjesë e rëndësishme e funksionit të kësaj qendre do të jetë kryerja e studimeve për komunitetin arbëresh, promovimin, ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kulturor tek ky komunitet si dhe me organizimin e aktiviteteve, seminareve dhe konferencave shkencore të cilat do të kenë si focus komunitetin arbëresh. Gjithashtu botimi i studimeve të QSPA-së do të kryhet në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën.



"Nëna Arbëri" koncerti i organizuar në Piana degli Albanesi


Në komunën arbëreshe Piana degli Albanesi në Palermo Itali, Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe në bashkëpunim me komunën organizoi koncertin "Nëna Arbëri". Ky koncert i mbajtur me rastin e tre vjetorit të shenjtërit të Nënë Terezës ngjiti në skenë artistë shqiptarë me famë ndërkombëtare si Inva Mula, Olen Cezari, David Tukici si dhe artistë italianë si Pierpaolo Petta, Roberta Finocchiaro, Massimo Spata. E pranishme në këtë mbrëmje drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës znj. Etleva Kondi shprehu mirënjohjen për mikpritjen nga publiku i komunës së Piana degli Albanesi dhe mbi të gjitha bashkëpunimin e tyre për të organizuar një koncert me përmasa të tilla.



Miratohet literatura shtesë për mësimdhënien në Diasporë

U zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën ku mori pjesë edhe Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko, i cili prezantoi drejtuesin e ri të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, drejtorin e Bibliotekës Kombëtare, z.Piro Misha. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte miratimi i literaturës plotësuese të gjuhës shqipe, të cilat do t'u vijjnë në ndihmë fëmijëve të grupmoshave të ndryshme në Diasporë. Grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit pranë QBD-së paraqiti 10 propozime bazuar në kriterin e cilësisë përmbajtësore dhe estetike duke iu përmbajtur grupmoshave dhe nivelit të njohurive më gjuhën shqipe. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën miratoi një pjesë të listës së propozuar dhe sugjeroi shtimin e disa titujve të tjerë.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



Shqiptarët kudo gjenden kanë mundësi të njihen në kohë reale me gjithçka ndodh në Diasporën Shqiptare. Kjo, falë aplikacionit më të ri "Diaspora Shqiptare", i cili gjendet falas në dyqanet virtuale. Synimi i këtij aplikacioni është që të ofrojë informacion të plotë për gjithçka ndodh në Diasporë, të pasqyrojë aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha të jetë pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" do të jetë një platformë aktive për të gjithë veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë. Nëpërmjet këtij aplikacioni do të vijjnë te ju lajme, analiza, ide, sugjerime dhe komente lidhur me realitetin shqiptar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" mund ta shkarkoni falas në dyqanet virtuale:

https://apps.apple.com/us/app/diasporashqiptare/id1473128308?fbclid=IwAR1gBqVqpCimmbiSDO_U5dFOtd27TIB_gL9BAAdRslcUfRCzJWBKb1rtJnU

https://play.google.com/store/apps/details?id=org.nativ.escript.diaspora&hl=en&fbclid=IwAR0L2kFwUnPU0reQpWIBLPCQLM6UQkIqXd67w4CjIP_IOfpmfyoNyM3BVGQ



Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Drejtues të FSHZHD

Në mbledhjen e radhës, Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës miratoi projektin dhe buxhetin e vitit 2019 "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës – Krijimi dhe Nxitja e Investimeve të Diasporës në Shqipëri", dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të financuar nga Këshilli i Ministrave. Projekti i Dhomës së Biznesit të Diasporës ka si qëllim të asistojë dhe mbështesë në ngritjen dhe funksionimin e kësaj dhome, si një mekanizëm për angazhimin e Diasporës në nxitjen e sipërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e profileve të investimeve në Shqipëri që do të mundësohen përmes aktiviteteve.



Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, zhvilloi një takim pune në Kroaci



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për bashkëpunim institucional për çështjet e Diasporës dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në Kroaci, në veçanti Arbëreshëve të Zares, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Gjatë bashkëbisedimit znj. Kondi njohu homologët kroat me politikën shtetërore të hartuara për Diasporën, misionin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, projektet e realizuar nga ky institucion dhe bashkëpunimi me komunitet shqiptarë në Diasporë për ruajtjen e identitetit kombëtar. Në kuadër të bashkëpunimit institucional do të përfshihet mësimi i gjuhës dhe kulturës shqiptare dhe realizimi i një projekti pilot me mësues të gjuhës shqipe të cilët do të identifikojnë nevojat e duhura për t'u ardhur në ndihmë nxënësve të këtij komuniteti.

Koncerti "Diaspora Artistike dhe Shkencore - SHBA"

Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Ministri i Shtetit për Diasporën organizojnë të dielën më 8 shtator koncertin "Diaspora Artistike dhe Shkencore - SHBA", me pjesëmarrjen e pianistit shqiptar që jeton në SHBA Redi Llupa dhe violonçelistit argjentinas Juan Sebastian Delgado. Koncerti përmban një repertor të pasur muzikor me pjesë të kompozitorëve shqiptarë të njohur si Thomas Simaku, Vasil S Tole, Tonin Harapi, Thomas Simaku, si dhe pjesë të njohura nga kompozitorët Astor Piazzola, Manuel de Falla etj. Koncerti "Diaspora artistike dhe shkencore SHBA" mbahet në sallën "Aleks Buda", Akademia e Shkencave të Shqipërisë, të dielën ora 19:00.



Akademia e Shkencave e Shqipërisë
në bashkëpunim me
MINISTRINË E DIASPORËS



Dr. Redi Llupa
piano
SHBA - SHQIPËRI



Dr. Juan Sebastian Delgado
violonçel
KANADA - ARGJENTINË